

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

7 shkurt 2012

Ap – Kz 373/10

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Horst Proetel si Kryetar i kolegjit, gjyqtaret e Gjykatës Supreme Marije Ademi dhe Nesrin Lushta si edhe gjyqtarët e EULEX-it Francesco Florit dhe Gerrit-Marc Sprenger si anëtarë të kolegjit, me asistimin e Zyrtares Ligjore Chiara Rojek si procesmbajtëse,

Në lëndën penale kundër

Hajriz GASHI, pa nofkë, i biri i [i] i lindur më [i] dhe me vendbanim në fshatin [i], Komuna e [i], Kosovë, [i] shkollimi më i lartë është shkolla e mesme, i papunë, me gjendje ekonomike të dobët, në paraburgim që nga 20 shtator 2008 deri më 11 janar 2010,

I akuzuar sipas aktakuzës PP. nr. 104/08 të datës 10 mars 2009 dhe së fundi e ndryshuar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 29 prill 2010, për veprat penale Vrasje në kundërshtim me Nenin 146 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), Vrasje në tentativë në kundërshtim të Nenit 146 të lexuar në lidhje me Nenin 20 të KPK, dhe Mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të Armëve në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 1 të KPK,

I dënuar në shkallën e parë me aktgjykimin P nr. 24/09 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 10 qershor 2010 për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të Armëve në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe i dënuar me katër (4) vjet burgim; i liruar nga akuzat për Vrasje në kundërshtim me Nenin 146 të KPPK dhe Vrasje në tentativë në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar në lidhje me Nenin 20 të KPPK,


Kasum GASHI, pa nofkë, i biri i [i] i lindur më [i] dhe me banim në fshatin [i], Komuna e [i], Kosovë, [i] shkollimi më i lartë është shkolla e mesme, me të ardhura mujore prej 400 euro,

I akuzuar sipas aktakuzës PP. nr. 104/08 të datës 10 mars 2009 dhe së fundi e ndryshuar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 29 prill 2010, për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të Armëve në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 1 të KPK,

I dënuar në shkallën e parë me të njëjtin aktgjykim për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të Armëve në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 2 të KPK, dhe i dënuar me tri (3) vjet burgim,

Dhe **Shaqir GASHI**, me nofkën Shaqe, i biri i [i] i lindur më [i] dhe me banim në fshatin [i]

Komuna e [i]



, shkollimi më i lartë është shkolla fillore, i papunë, me gjendje ekonomike të dobët, pa dënim të njohur më parë, në paraburgim që nga 20 shtator 2008 deri më 11 janar 2010,

I akuzuar sipas aktakuzës PP. nr. 104/08 të datës 10 mars 2009 dhe së fundi e ndryshuar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 29 prill 2010, me veprën penale në vijim Shtytja për të kryer Vrasje në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar në lidhje me Nenin 24 të KPK, Shtytja për të kryer Vrasje në tentativë në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar në lidhje me Nenin 20 dhe 24 të KPK, dhe Mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të Armëve në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 1 të KPK, I liruar në shkallën e parë nga të gjitha akuzat me të njëjtin aktgjykim,

Duke vepruar sipas ankesës të ushtruar nga Prokurori Publik i Qarkut Neeta Amin më 10 gusht 2010, ankesës të ushtruar nga avokati mbrojtës Adem Vokshi në emër të të pandehurit Hajriz Gashi më 25 gusht 2010, ankesës të ushtruar nga avokati mbrojtës Arif Hasi në emër të të pandehurit Kasum Gashi më 18 gusht 2010, dhe ankesës të ushtruar nga avokati Fadil I. Hoxha në emër të palës së dëmtuar Jonuz Gashi më 18 gusht 2010 kundër aktgjykimit P nr. 24/09 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 10 qershor 2010, dhe duke marrë parasysh përgjigjën në ankesat e ushtruar nga avokati mbrojtës Zekir Maxhuni në emër të të pandehurit Shaqir Gashi më 20 shtator 2010 dhe Mendimin nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) paraqitur më 26 gusht 2011,

Pas mbajtjes së seancës së hapur më 7 shkurt 2012 në praninë e të pandehurit Kasum Gashi, avokatit të tij mbrojtës Arif Hasi dhe avokatit Hamdi Jashanica, përfaqësues i palës së dëmtuar Jonuz Gashi, pas këshillimit dhe votimit të njëjtën ditë,

Në pajtueshmëri me Nenet 420, 423 dhe 426 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), lëshon këtë

AKTGJYKIM

Ankesa e ushtruar nga Prokurori Publik i Qarkut më datën 10 gusht 2010 kundër aktgjykimit P nr. 24/09 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 10 qershor 2010 MIRATOHET.


Ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës Adem Vokshi në emër të të pandehurit Hajriz Gashi më datën 25 gusht 2010 kundër aktgjykimit P nr. 24/09 MIRATOHET pjesërisht.

Ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës Arif Hasi në emër të të pandehurit Kasum Gashi më datën 18 gusht 2010 kundër aktgjykimit P nr. 24/09 MIRATOHET pjesërisht.

Ankesa e ushtruar nga avokati Fadil I. Hoxha në emër të palës së dëmtuar Jonuz Gashi më datën 18 gusht 2010 kundër aktgjykimit P nr. 24/09 REFUZOHET si e papranueshme.

Aktgjykimi P nr. 24/09 i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë i datës 10 qershor 2010 NDRYSHOHET me sa vijon:

I pandehuri **Hajriz Gashi**, me të dhëna personale të paraqitura më lart, është shpallur fajtor për veprën penale Vrasje në kundërshtim me Nenin 146 të KPK sepse më 20 shtator 2008 rreth orës 13:00, në lagjen "Gashi", në fshatin Kryshevë, Komuna e



Skenderajt me pushkë automatike AK 47 të kalibrit 7,62x39mm me numër serik C-43367 ka shkrepur 10 të shtëna në drejtim të Abedin Gashi dhe Kasum Gashi, duke e goditur dhe në këtë mënyrë duke shkaktuar vdekjen e menjëhershme të Abedin Gashi.

I pandehuri Hajriz Gashi është shpallur fajtor për veprën penale Vrasje në tentativë në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar në lidhje me Nenin 20 të KPK sepse më 20 shtator 2008 rreth orës 13:00, në lagjen "Gashi", në fshatin Kryshevc, Komuna e Skenderajt me pushkë automatike AK 47 të kalibrit 7,62x39mm me numër serik C-43367 ka shkrepur 10 të shtëna në drejtim të Abedin Gashi dhe Kasum Gashi, duke e goditur Kasum Gashin dhe në këtë mënyrë i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore Kasum Gashit në krahun e djathtë.

I pandehuri Hajriz Gashi është shpallur fajtor për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të Armëve në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 2 të KPK sepse më 20 shtator 2008 rreth orës 13:00, në lagjen "Gashi", në fshatin Kryshevc, Komuna e Skenderajt me pushkë automatike AK 47 të kalibrit 7,62x39mm me numër serik C-43367 ka shkrepur 10 të shtëna në drejtim të Abedin Gashi dhe Kasum Gashi, duke e goditur secilin me një plumb dhe duke shkaktuar në këtë mënyrë vdekjen e menjëhershme të Abedin Gashi dhe duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore Kasum Gashi në krahun e djathtë.


I pandehuri Hajriz Gashi prandaj është dënuar me pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim në pajtueshmëri me Nenin 147 Pika 11 të KPK për veprat Vrasje në kundërshtim me Nenin 146 dhe Vrasje në tentativë në kundërshtim me Nenin 146 të lexuar në lidhje me Nenin 20 të KPK.

Dënimi prej katër (4) vjet burgim i shqiptuar ndaj të pandehurit Hajriz Gashi në shkallën e parë me aktgjykimin P nr. 24/09 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më datën 10 qershor 2010 për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të Armëve në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 2 të KPK, modifikohet në një vit e gjysmë (1,5) burgim.

I pandehuri Hajriz Gashi dënohet me një dënim unik prej gjashtëmbëdhjetë (16) vjet burgim në pajtueshmëri me Nenin 71 të KPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga 20 shtator 2008 deri më 11 janar 2010 do të llogaritet në pajtueshmëri me Nenin 73 paragrafi 1 të KPK. Aktvendimi për paraburgimin do të jepet ndaras.

Dënimi prej tri (3) vjet burgim i shqiptuar ndaj të pandehurit **Kasum Gashi**, me të dhëna personale të paraqitura më lart, në shkallën e parë me aktgjykimin P nr. 24/09 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 10 qershor 2010 për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të Armëve në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 2 të KPPK modifikohet në një vit e gjysmë (1,5) burgim.



Shpenzimet e procedurës penale në shkallën e dytë do të paguhen nga të pandehurit Hajriz Gashi dhe Kasum Gashi sipas neneve 99, 100 dhe 103 të KPPK-së.

ARSYETIM

I. Historia e procedurës

Lënda ka të bëjë me një ngjarje e cila ka ndodhur më 20 shtator 2008, rreth orës 13:00 në fshatin Kryshevc, Komuna e Skenderajt. Pas mosmarrëveshjeve në mes të dy familjeve fqinje, Kasum Gashi dhe vëllai i tij Abedin Gashi, kanë shkuar në shtëpinë e Shaqir dhe Hajriz Gashit. Kasum Gashi ka nxjerrë revolen dhe Hajrizi kërkonte një armë automatike. Të dy kanë shtënë me armët e tyre në drejtim të njëri tjetrit. Abedin Gashi është qëlluar për vdekje. Kasumi është plagosur në krahun e djathtë.

Më 10 mars 2009, Prokurori i EULEX-it ka ngritur aktakuzën e Prokurorit PP. nr. 104/08, me të cilën:

I pandehuri **Hajriz Gashi** është akuzuar për Vrasje të rëndë në kundërshtim të nenit 147, paragrafit 1, pikës 3 të KPK-së (pika 1); dhe Vrasje të rëndë në tentativë në kundërshtim të nenit 147, paragrafit 1, pikës 3 në lidhje me nenin 20 të KPK-së (lidhur me pikën e parë - pika 2);

I pandehuri **Shaqir Gashi** është akuzuar për Shtytje për të kryer Vrasje të rëndë në kundërshtim të nenit 147, paragrafit 1, pikës 3 të KPK-së në lidhje me nenin 24 të KPK-së (pika 1); dhe Shtytje për të kryer veprën penale Vrasje e rëndë në tentativë në kundërshtim të nenit 147, paragrafit 1, pikës 3 të KPK-së në lidhje me nenet 20 dhe 24 të KPK-së (pika 2).


I pandehuri **Kasum Gashi** është akuzuar për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328, paragrafi 1 i KPK-së.

Më 11 janar 2010, aktakuza është konfirmuar me aktvendimin KA nr. 24/09 me ndryshimet në vijim. **Hajriz Gashi** është akuzuar për veprën penale Vrasje në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së dhe Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së në lidhje me nenin 20 të KPK-së. **Shaqir Gashi** është akuzuar për Shtytje për të kryer Vrasje në kundërshtim të nenit 146 në lidhje me nenin 24 të KPK-së, dhe Shtytje për të kryer Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 146 në lidhje me nenet 20 dhe 24 të KPK-së. Gjyqtari për konfirmim ka gjetur se asnjëri prej fakteve apo provave nuk e kanë mbështetur cilësimin juridik Vrasje e rëndë dhe Vrasje e rëndë në tentativë. Sa i përket **Kasum Gashit**, aktakuza me akuzën origjinale është konfirmuar në tërësi.

Gjykata e shkallës së parë ka mbajtur seancat gjyqësore më 30, 31 mars, 27, 29 prill, 31 maj dhe 10 qershor 2010.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor më 31 mars 2010, Prokurori Publik ka paraqitur një ndryshim në aktakuzë sipas nenit 376, paragrafit 1 të KPK-së.¹ Më 27 prill 2010², diskutimi në

¹ Prokurori ka propozuar të shtohet pika për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328, paragrafi 2 të KPK-së kundër Shaqir Gashit.



lidhje me ndryshimet e aktakuzës janë shtyrë për seancën e ardhshme. Përfundimisht më 29 prill 2010,³ Hajriz dhe Shaqir Gashi janë akuzuar më tutje për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328, paragrafit 2 të KPK-së.

Më 10 qershor 2010, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka lëshuar aktgjykimin P. nr. 24/09⁴ me anë të cilit:

I pandehuri **Hajriz Gashi** është shpallur fajtor për Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328, paragrafit 2 të KPPK-së dhe është dënuar me katër (4) vite burgim, “sepse më 20 shtator 2008, rreth orës 13:00, në lagjen “Gashi”, në fshatin Kryshevc, komuna e Skenderajt ka shtënë 10 herë me pushkë automatike AK 47 të kalibrit 7,62x39mm me numër serik C-43367 në drejtim të Abedin Gashit dhe Kasum Gashit, duke e qëlluar secilin me nga një plumb dhe duke i shkaktuar vdekje të menjëhershme Abedin Gashit dhe lëndime të rënda trupore Kasum Gashit në krahun e tij të djathtë.” Koha e kaluar në paraburgim nga 20 shtatori 2008 deri më 11 janar 2010 do të llogaritet sipas nenit 73, paragrafit (1) të KPPK-së.

Hajriz Gashi është liruar nga akuza e mbetur e Vrasjes në kundërshtim të nenit 146 të KPK-së, dhe Vrasjes në tentativë në kundërshtim të nenit 146 në lidhje me nenin 20 të KPK-së, sipas nenit 390, pikës 3 të KPPK-së, “sepse nuk ka mundur të përjashtohet se ai ka vepruar në mbrojtje të nevojshme sipas nenit 8, paragrafit (2) të KPPK-së kur më 20 shtator 2008, rreth orës 13:00, në lagjen “Gashi”, në fshatin Kryshevc, komuna e Skenderajt, ka shtënë 10 herë me pushkë automatike AK 47 të kalibrit 7,62x39mm me numër serik C-43367 në drejtim të Abedin Gashit dhe Kasum Gashit, duke e qëlluar secilin me nga një plumb dhe duke i shkaktuar vdekje të menjëhershme Abedin Gashit dhe lëndime të rënda trupore Kasum Gashit në krahun e tij të djathtë.”


I pandehuri **Kasum Gashi** është shpallur fajtor për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328, paragrafit 2 të KPK-së dhe është dënuar me tri (3) vjet burgim, “sepse më 20 shtator 2008, rreth orës 13:00, në lagjen “Gashi” në fshatin Kryshevc, komune e Skenderajt ka shtënë tri herë me revolen Crvena Zastava M-57 të kalibrit 7,62x25 mm me numër serik C-139535 në drejtim të dritares së shtëpisë së Shaqir Gashit.”

I pandehuri i tretë **Shaqir Gashi** është liruar nga të gjitha akuzat.

² Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, lënda P. nr. 24/09, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 27 prill 2010, faqe 23.

³ Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, lënda P. nr. 24/09, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 29 prill 2010, faqet 2-5: Prokurori ka paraqitur ndryshimin e dytë si në vijim: pika 4 kundër Shaqir Gashit për Vrasje të rëndë në kundërshtim të nenit 147, paragrafëve 5 dhe 9 të KPPK-së; pika 3 kundër Hajriz Gashit për Vrasje të rëndë në kundërshtim të nenit 147, paragrafëve 5 dhe 9 të KPPK-së.

⁴ Gjykata e Qarkut gjithashtu ka urdhëruar që armët e përdorura për kryerjen e veprave penale të konfiskohen sipas nenit 60, paragrafit 1 dhe nenit 328 paragrafit (5) të KPPK-së; dhe për të pandehurit Hajriz Gashi dhe Kasum Gashi të kompensojnë pjesën e tyre të shpenzimeve të procedurës penale sipas nenit 102 paragrafit (1) të KPPK-së.



II. Parashtrësit e palëve

A. Ankesa e Prokurorit Publik

Prokurorja e EULEX-it ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 të KPPK-së; shkeljes së ligjit penal sipas nenit 404 të KPPK-së; dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sipas nenit 405 të KPPK-së, në lidhje me nenet 387 dhe 396 paragrafin 7 të KPPK-së. Ajo i propozon Gjykatës Supreme që ta aprovojë ankesën dhe të ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë ose ta kthejë lëndën në rigjykim.

Prokurorja pretendon në shkelje të nenit 403 paragrafit 1 pikës 12 të KPPK-së, pasi që ekzistojnë mospërputhje në mes të arsytimit që kanë të bëjnë me përmbajtjen e dokumenteve ose dëshmimeve të dhëna gjatë procedurës në njërin anë dhe këtyre dokumenteve ose vetë dëshmimeve në anën tjetër.

Lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, Prokurorja Publike pohon se gjykata e shkallës së parë i ka bazuar gjetjet e saj vetëm në dëshmitë e drejtpërdrejta të dëshmitarëve të dëgjuar në Gjykatë dhe nuk ka ndjekur provat e mbledhura gjatë hetimeve. Rrjedhimisht, gjetjet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me provat dhe kredibilitetin e dëshmitarëve nuk janë të plota dhe janë të gabuara.⁵

Prandaj, ekziston një shkelje e ligjit penal, respektivisht ligjit mbi vetëmbrojtjen. Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh nëse akti i kryer nga **Hajriz Gashi** ka qenë jo-proporcional me shkallën e rrezikut të shkaktuar nga një sulm dhe ka tejkalluar kufijtë e mbrojtjes së nevojshme. Prandaj, Gjykata gabimisht ka vërtetuar kushtet ligjore të mbrojtjes së nevojshme.⁶ Për më tepër, i pandehuri është liruar sipas nenit 390 pikës 3 të KPPK-së, dhe jo sipas nenit 8 paragrafit 1 të KPPK-së.

Përfundimisht, Prokurorja pretendon se Gjykata e Qarkut ka bërë vërtetim të gabuar të provave të forenzikës sa i përket gëzhgojave të gjetura në vendin e krimit.

B. Ankesa e paraqitur në emër të pandehurit Hajriz Gashi

Mbrojtja pretendon në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafit 1 pikës 10 dhe paragrafit 2 pikës 1 të KPPK-së; shkelje të kodit penal sipas nenit 404 paragrafit 1 pikave 1-5 të KPPK-së; dhe vendimin mbi sanksionimin penal sipas nenit 406 paragrafit 1 të KPPK-së.


Prandaj, ai i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës që ta aprovojë ankesën dhe:

- Ta kthejë lëndën në shkallën e parë për rigjykim; ose
- Ta ndryshoj aktgjykimin kundër **Hajriz Gashit** ta refuzojë aktakuzën sipas nenit 384 paragrafit 1 pikës 3 në lidhje me nenin 386 paragrafin 1, dhe nenin 390 paragrafin 1 pikën 3 të KPPK-së.

Sa i përket shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale, mbrojtja kundërshton se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas neneve 386 dhe 376 të KPPK-së kur ka konfirmuar aktakuzën e ndryshuar në mënyrë verbale gjatë shqyrtimeve.

⁵ Prokurori i referohet aktgjykimin P. nr. 24/09 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 10 qershor 2010, paragrafit C, faqe 7.

⁶ Prokurori i referohet aktgjykimin P. nr. 24/09, paragrafit E.2, faqe 22



gjqësore më 27 dhe 29 prill 2010. Me këtë, Gjykata e Qarkut ka shkelur Nenin 403 Paragrafin 1 Pikën 10 të KPPK-së. Avokati mbrojtës po ashtu kundërshton dënimin me katër (4) vjet burgim për akuzën e armës.

Avokati mbrojtës parashtron se Gjykata e Shkallës së Parë ka bërë shkelje të ligjit penal, përkatësisht të Nenit 384 Paragrafit 1 Pikës 3 të KPPK-së.⁷ Në këtë lëndë, akuza e prokurorisë u finalizua dhe përshkrimi faktik i veprave nuk kishte ndryshuar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Avokati mbrojtës parashtron se shpjegimi i vetëm për një dënim të tillë është qëllimi i përgjithshëm i dënimit dhe përmbajtja e të pandehurit për përsëritjen e veprës penale. Gjykata e Shkallës së Parë nuk mori parasysh si rrethanë lehtësuese se **Hajriz Gashi** ishte sulmuar dhe i shtyrë në pozitë të mbrojtë veten dhe familjen e tij.

C. Ankesa e ushtruar në emër të të pandehurit Kasum Gashi

Mbrojtja kundërshton Aktgjykimin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga Neni 403 i KPPK-së; shkeljes së ligjit penal nga Neni 404 i KPPK-së; dhe vendimit mbi sanksionet penale nga Neni 406 i KPPK-së. Prandaj, ai i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës ta pranojë ankesën dhe anulojë aktgjykimin e Shkallës së Parë dhe:


- ta kthejë lëndën në rigjykim; ose
- ta ndryshojë aktgjykimin ashtu që i pandehuri të lirohet.

Mbrojtja pretendon në shkelje të Nenit 403 Paragrafit 1 Pikës 12 se Aktgjykimi nuk është i bazuar në provat e paraqitura. Nuk ekzistojnë arsye lidhur me faktet materiale dhe kishte një kundërthënie në mes arsyetimit lidhur me përmbajtjen e provës materiale të dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe asaj të marrë gjatë hetimit. Gjykata e Qarkut po ashtu nuk arriti të bëjë rikonstruktimin e vendit të ngjarjes. Mbrojtja pohon disa kundërthënie dhe shkelje në këtë Aktgjykim, posaçërisht për shkak se kundër **Kasum Gashit** ishte kryer një vrasje në tentativë. Gjykata e Shkallës së Parë, pa marrë parasysh rrethanat, nuk zbatoi drejt dispozitat që kanë të bëjnë me veprat penale të Vrasjes në tentativë dhe Lëndimit të rëndë trupor, p.sh. të shtënit nga një largësi prej 10 metrash nga prapa me armë automatike në drejtim të pjesëve të epërme vitale të trupit.

Mbrojtja kundërshton edhe përfundimet e Gjykatës së Shkallës së Parë për disa elemente: se **Kasum Gashi** nuk foli; se tre plumbat e shkrepur në vetëmbrojtje nga **Kasum Gashi** ishin shtënë përballë ballkonit prej nga kishte shtënë **Hajriz Gashi**. Nuk ka asnjë provë se Hajriz Gashi veproi në vetëmbrojtje të nevojshme. Sipas pikëpamjes së Mbrojtjes, Gjykata e Qarkut nuk është dashur ta shpallë **Kasum Gashin** fajtor për akuzën nga Neni 328 i KPPK-së pasi që ai veproi në mbrojtje të nevojshme.

Mbrojtja pretendon në shkelje të ligjit penal, duke supozuar se Gjykata e Qarkut nuk veproi në përputhje me Nenet 14 dhe 15 të KPPK-së. Mbrojtja parashtron se Gjykata e Qarkut është dashur ta lirojë **Kasum Gashin** ose t'ia shqiptojë atij një masë më të butë. Dënimi i shqiptuar është në kundërshtim me ligjin dhe praktikën në Kosovë.

⁷ Neni 384 Paragrafi 1 Pika 3 e KPPK-së: "(1) Trupi gjykues me vendim e hedh aktakuzën: [...] 3) Kur ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përkohësisht e pengojnë ndjekjen."



D. Ankesa e ushtruar në emër të Palës së dëmtuar Jonuz Gashi

Si vërejtje paraprake, Avokati Hoxha heq dorë nga e drejta për t'iu dorëzuar aktgjykimi i kundërshtuar, dhe prandaj pranon se Aktgjykimi konsiderohet se është dorëzuar në momentin se parashtrimi të ankesës, me qëllim të shmangies së vonesës së procedurës. Megjithatë, aktgjykimin nuk e kanë pranuar as ai e as pala e dëmtuar.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar propozon Gjykatës Supreme të Kosovës ta pranojë ankesën dhe:

- ta kthejë lëndën në rigjykim; ose
- ta ndryshojë Aktgjykimin, ashtu që **Hajriz Gashi** të shpallet fajtor dhe të dënohet për dy pika të Vrasjes së rëndë në përputhje me Nenin 147 Paragrafët 5 dhe 9 kundër Abedin dhe **Kasum Gashit**; dhe **Shaqir Gashi** të shpallet fajtor për dy pika të Shtytjes së vrasjes së rëndë në përputhje me Nenin 147 Paragrafët 5 dhe 9 të KPK-së kundër Abedin dhe **Kasum Gashit**; dhe të lirohet **Kasum Gashi** nga dënimi i tij.

Avokati Hoxha mbështet plotësisht ankesën e Prokurorit Publik dhe ankesën e ushtruar në emër të të pandehurit **Kasum Gashi**. Përveç kësaj, ai përmend disa elemente të vërtetuara me anë të dëshmimeve të dëshmitarëve dhe provave mjekoligjore që Gjykata e Qarkut i ka lënë jashtë apo i ka interpretuar gabimisht. Ai pretendon se veprimet e të pandehurit ishin të paramenduara, dhe se Gjykata e Shkallës së Parë gabimisht zbatoi dispozitat e mbrojtjes së nevojshme.

Veç kësaj, Gjykata e Qarkut gabimisht u mbështet në dëshmitë e dhëna nga të pandehurit kurse Gjykata anashkaloi dëshminë e **Kasum Gashit** dhe nuk a mori parasysh pranimin e fajësisë nga ai për akuzën e armës. Në fund, Avokati Hoxha pohon se Gjykata e Qarkut nuk ka analizuar drejt elementet e përgjegjësisë nga Neni 15 i KPK-së.


E. Përgjigja ndaj Ankesave e paraqitur nga Avokati mbrojtës për të pandehurin Shaqir Gashi

Në Përgjigjen e tij, Avokati mbrojtës Zeqir Maxhuni i propozon Gjykatës Supreme t'i refuzojë si të pabazuara ankesat e ushtruara nga Pala e dëmtuar Jonuz Gashi dhe i pandehuri **Kasum Gashi**. Ai përmend se, në shqyrtimin gjyqësor, Avokati Fadil Hoxha hoqi dorë nga e drejta e tij për ushtrimin e padisë pronësore, dhe rrjedhimisht, ankesa duhet të hidhet poshtë në përputhje me Nenet 46 deri 52 dhe Nenin 108 të KPPK-së. Ankesa e ushtruar në emër të **Kasum Gashit** nuk përmban asnjë kërkesë për zhvlerësimin e gjetjeve të Gjykatës së Shkallës së Parë.

F. Mendimi i ZPSHK-së

Prokurori i Shtetit i Kosovës, në përputhje me Nenin 420 Paragrafin 1, nën paragrafin 2, dhe Nenin 423 të KPPK-së, shtyn Gjykatën Supreme të Kosovës ta pranojë ankesën dhe:

- ta ndryshojë Aktgjykimin, duke dënuar **Hajriz Gashin** për veprën e Vrasjes në kundërshtim me Nenin 146 të KPK-së dhe veprën e Vrasjes në *tentativë* në kundërshtim me Nenin 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së; ose
- ta kthejë lëndën në rigjykim në Shkallë të Parë; dhe



- ti refuzojë të gjitha ankesat e tjera si të pabazuara dhe ta vërtetojë Aktgjykimin e kundërshtuar, në pjesët e mbetura.

Sipas këndvështrimit të ZPSHK-së, Aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale; vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkelje të ligjit penal.

Ankesa e Prokurorit Publik

Prokurori i Shtetit plotësisht e miraton ankesën e Prokurorit Publik përkitazi me shkeljet e dispozitave të procedurës penale. Gjykata e Qarkut nuk i dha arsyet pse këto kundërhënie dhe mospërputhshmëri nuk mund të qartësohen. Gjykata as nuk i vuri ato përballë dëshmive të dëshmitarëve dhe të dyshuarve të dhëna në fazën e mëhershme, e as nuk e justifikoi këtë vendim *in dubio pro reo*. Përveç kësaj, mungon një arsyetim i bazuar ligjërisht sa i përket elementeve të mbrojtjes së nevojshme.

Prokurori i Shtetit i Kosovës e mbështet pikëpamjen e Prokurorit Publik mbi shkeljen e ligjit penal se Gjykata e Qarkut gabimisht nuk ka përjashtuar se Hajriz Gashi veproi në mbrojtje të nevojshme nga Neni 8 i KPK-së. Në këtë shkallë nuk ishin plotësuar elementet objektive të një sulmi real dhe të pashmangshëm. Si pasojë, në vend të kësaj Gjykata gabimisht e cilësoi veprën penale të **Hajriz Gashit** nga Neni 328 Paragrafi 2 i KPK-së, si Vrasje dhe Vrasje në tentativë në kundërshtim me Nenin 146 dhe Nenin 146 lidhur me Nenin 20 të KPK-së.

Prokurori i Shtetit i Kosovës pohon se Gjykata e Qarkut procedoi me një vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Për më tepër, Prokurori i Shtetit mendon se trupi gjykues po ashtu gabimisht vërtetoi provat mjekoligjore të paraqitura në anën e **Hajriz Gashit**. Në fund, rikonstruktimi i vendit të ngjarjes do të na mundësonte të kuptonim më mirë rrethanat e atyre ndodhive.


Ankesa e të pandehurit Hajriz Gashi

Prokurori i Shtetit në Aktgjykim gjen shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe të ligjit penal sa i përket **Hajriz Gashit**, sepse ai duhet të dënohet, jo vetëm për shkak të veprës penale nga Neni 328 Paragrafi 2 i KPK-së, por edhe për shkak të Vrasjes dhe Vrasjes në tentativë. ZPSHK-ja vetëm përsërit mendimin se Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka zbatuar drejt ligjin mbi vetëmbrojtjen. Vendimi mbi sanksionet penale nuk është në përputhje me ligjin pasi që **Hajriz Gashi** duhet të dënohet gjithashtu edhe për Vrasje dhe Vrasje në tentativë.

Ankesa e të pandehurit Kasum Gashi

Prokurori i Shtetit pretendon se **Kasum Gashi** si i pandehur në këtë lëndë, nuk mund të konsiderohet si palë e dëmtuar. Prandaj ai nuk ka të drejtë të ushtrojë ankesë kundër aktgjykimit përkitazi me **Hajriz** dhe **Shaqir Gashin**, në përputhje me Nenin 398 dhe 399 Paragrafin 2 të KPPK-së.

Sipas mendimit të ZPSHK-së, Aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban asnjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ose shkelje të ligjit penal. Është e pamohueshme se **Kasum Gashi** ka kryer veprën penale të Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve. Prokurori i Shtetit gjen se Gjykata e Qarkut mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të veprës



penale të shënuara në Nenin 64 të KPK-së, dhe prandaj dënimi i shqiptuar nuk është i pabarabartë me veprën e kryer penale.

Ankesa e Palës së dëmtuar Jonuz Gashi

Prokurori i Shtetit i Kosovës shtyn Gjykatën Supreme në përputhje me Nenin 420 Paragrafin 1 Pikën 1 të KPPK-së ta hedhë poshtë ankesën si të papranueshme mbi bazë të sanksionit penal për veprën penale nga Neni 328 i KPPK-së pasi që ankesa ishte ushtruar nga personi i paautorizuar. Jonuz Gashi nuk është palë e dëmtuar përkitazi me akuzën e armës dhe shkelja e Neni 328 të KPK-së nuk bie nën nenin 399 Paragrafin 3 të KPPK-së. Sa i përket shfajësimin të **Shaqir Gashit**, Prokurori i Shtetit ndan mendimin me Gjykatën e Shkallës së Parë dhe ankesa nuk shtjellon asnjë provë që do të mund të bënte një ndryshim në marrjen parasysh të provave nga Gjykata e Shkallës së Parë.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

A. Kompetenca dhe procedura para Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës është kompetente për të vendosur mbi Ankesat në përputhje me Nenin 26 Paragrafin 1 dhe Nenet 398 e tutje të KPPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme është përbërë në përputhje me Nenin 3 Paragrafin 7 të Ligjit Nr. 03/L-53 mbi Kompetencat. Kolegji i Gjykatës Supreme mbajti një seancë publike më 7 shkurt 2012. Palët ishin njoftuar lidhur me seancën. Avokati mbrojtës Adem Vokshi me anë të letrës së datës 30 janar njoftoi Gjykatën Supreme se ai nuk do të merrte pjesë në seancë dhe se qëndron prapa ankesës së tij.

B. Pranueshmëria e Ankesave të ushtruara nga pala e dëmtuar

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë e shpalli Aktgjykimi në lëndën P nr. 24/09 më 10 qershor 2010.


Prokurori Publik pranoi Aktgjykimin e kundërshtuar më 26 korrik 2010 dhe ushtroi Ankesë më 10 gusht 2010.

Avokati mbrojtës Adem Vokshi pranoi Aktgjykimin më 13 gusht 2010. Fletë dërgesa vërteton dorëzimin e aktgjykimit të i pandehuri **Hajriz Gashi** më 30 korrik 2010. Është e pamundur të vërtetohet në cilën datë e ka dërguar ankesën Avokati mbrojtës. Në Gjykatë është regjistruar më 25 gusht 2010.

Avokati mbrojtës Arif Hasi pranoi Aktgjykimin më 29 korrik 2010 siç vërtetohet me anë të fletë dërgesës. **Kasum Gashi** pranoi Aktgjykimin më 30 korrik 2010. Avokati mbrojtës Arif Hasi e dërgoi ankesën me postë më 11 gusht 2010. Ankesa ishte pranuar në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut më 18 gusht 2010.

Nuk ka asnjë fletë-kthesë për të përcaktuar kur e kanë pranuar Aktgjykimin Pala e dëmtuar dhe përfaqësuesi i tij ligjor. Avokati Fadil I. Hoxha e dërgoi Ankesën me postë më 11 gusht 2010. Në Shkrimoren e Gjykatë ajo është pranuar më 18 gusht 2010. Në ankesën e tij, ai përmendi se aktgjykimi nuk ishte dorëzuar as te ai e as te Jonuz Gashi. Megjithatë ai heq dorë nga e drejta për t'iu dorëzuar aktgjykimi.

Katër ankesat iu ishin dorëzuar palëve të tjera në shtator. Më 20 shtator 2010, Avokati mbrojtës Zekir Maxhuni për të pandehurin **Shaqir Gashi** paraqiti një Përgjigje ndaj



Ankesave të palës së dëmtuar dhe të pandehurit **Kasum Gashi**. Më 26 gusht 2011, ZPSHK-ja paraqiti një Mendim mbi Ankesat.

Ankesa e parashtruar nga Përfaqësuesi i Palës së dëmtuar Jonuz Gashi nuk lejohet, edhe nëse është paraqitur me kohë nga personi i autorizuar. Sa i përket dënimit të **Kasum** dhe **Hajriz Gashit** për veprën penale të Përdorimit dhe mbajtjes së paautorizuar të armëve sipas Nenit 328, par. 2 të KPK-së, pala e dëmtuar nuk ka të drejtë ta kundërshtojë vendimin. Neni 399, par. 3 i KPK-së shprehimisht kufizon të drejtën e palës së dëmtuar për të bërë ankesë ndaj “vendimit të gjykatës mbi **sanksionet ndëshkuese** për veprat penale të kryera ndaj jetës dhe trupit”. Vepra penale sipas Nenit 328 nuk siguron të drejtat individuale të një personi por të komunitetit *in toto*. Kjo duhet të kontrollohet nga Prokurori publik. E njëjta gjë vlen edhe për ankesën kundër **lirimit** të të pandehurve Hajriz dhe **Shaqir Gashi** për akuzat për Vrasje dhe Vrasje në tentativë edhe pse këto vepra penale janë kryer kundër jetës dhe trupit. Lirimi i të pandehurve **Gashi** nga gjykata e shkallës së parë nuk është “sanksion ndëshkues”. Është detyra e Prokurorit për t’u ankuar kur e sheh të nevojshme.

Ankesa e paraqitur në emër të të pandehurit **Kasum Gashi** është e pranueshme lidhur me dënimin për veprat penale të mbajtjes së paautorizuar të armëve. Megjithatë, pjesa tjetër e Ankesës lidhur me lirimin e të pandehurve **Hajriz** dhe **Shaqir Gashi** për Vrasje dhe Vrasje në tentativë nuk është e lejueshme sipas Nenit 399, par. 3 të KPPK-së, siç u shpjeguar edhe më lart.

Ankesat e tjera konsiderohen se janë paraqitur me kohë nga personi i autorizuar, dhe prandaj janë të pranueshme sipas Nenit 398, par. 1 të KPPK-së.


C. Meritat e Ankesave

Lidhur me të pandehurin Hajriz Gashi

Pranohet ankesa e paraqitur nga Prokurori publik i qarkut për ndryshimin e Aktgjykimit të shkallës së parë lidhur me **lirimin e Hajriz Gashit** për akuzat e Vrasjes dhe Vrasjes në tentativë, në kundërshtime me Nenin 146, lidhur me Nenin 20 të KPK-së. Gjykata Supreme në këtë drejtim po ashtu pajtohet me mendimin e Prokurorit të shtetit. Ankesa është e **bazuar** dhe e njëjta shpie tek dënimi i të pandehurit siç përshkruhet në dispozitiv. Gjykata Supreme mund të nxjerrë aktgjykim në dëm të të pandehurit **Hajriz Gashi** sepse prokuroria ka ushtruar ankesë ndaj Aktgjykimit të shkallës së parë. Mungesa e të pandehurit gjatë seancës ankimore nuk ka penguar zhvillimin e procedurës, sepse ai kishte qenë i njoftuar me kohë lidhur me seancën, po ashtu edhe avokati i tij, siç përcaktohet me Nenin 410, par. 4. Të dytë kanë qenë në dijeni lidhur me përmbajtjen e ankesës së Prokurorit.

Gjykata Supreme ndryshon **Aktgjykimin e ankimuar** në bazë të Nenit 424, par. 4, lidhur me Nenin 426 të KPPK-së sepse të gjitha faktet relevante janë vërtetuar nga Gjykata e qarkut, por pjesërisht **ndryshe të vlerësuar**. Kjo vlen kryesisht për gjetjet e gjykatës së shkallës së parë se nuk mund të **përfundohet mbrojtja e nevojshme** në kuptim të Nenit 8, par. 1 dhe 2 të KPK-së.

Gjykata Supreme nuk pajtohet me shqetësimet e gjykatës së shkallës së parë lidhur me pasigurinë e mbrojtjes së domosdoshme. Është e vërtetë se, në rast të dyshimit, **supozimi**



i pafajësisë kërkon zbatimin e parimit *in dubio pro reo*. Sidoqoftë, vlerësimi i fakteve dhe i provave, i cili gjithmonë duhet të kryhet **paraprakisht**, rezulton në atë se veprimi i të pandehurit **nuk ka qenë i nevojshëm për shmangien e “një sulmi të kundërligjshëm, real dhe të menjëhershëm”** nga vetja apo nga anëtarët e tjerë të familjes së tij.

Nuk ka asnjë indikacion që lidhet me lëndimin e shkaktuar nga Abedin Gashi. Edhe nëse fakti që ai erdhi bashkë me vëllain e vet të armatosur do të mund të konsiderohej si një kërcënim i shtuar, kjo gjë nuk e justifikon gjuajtjen në të. Përveç kësaj, **Kasum Gashi** ka përdorur armën duke thyer dritaret me disa plumba. Megjithatë, **Hajriz Gashi** ka qenë në vend të sigurt dhe nuk është rrezikuar nga të shtënat dhe nga afrimi i **Kasumit** dhe i **Abedin Gashit**. Madje edhe nëse deklarata e **Hajriz Gashit**⁸ do të kishte qenë e vërtetë, se gjoja Rasim Gashi u paraqit “me diçka në duar” duke thënë: “T’i gjuajmë me bomba...”, nuk është e besueshme të ndërhyhej me të shtëna nga arma automatike të drejtuar kundrejt personave në tokë. Tensionet në mes të familjeve fqinje atë ditë me siguri janë shtuar. Megjithatë, situata ka mundur të qetësohet pa shfrytëzimin e atyre mjeteve aq masive dhe aq të dhunshme. Është parë agresiviteti i pjesëtarëve të familjes së Jonuz Gashit. Kërcënimi i pohuar mbi bombardimin e shtëpisë nuk ka qenë real por, në të vërtetë një shprehje dëshpëruese e tërbimit.


Prokurori me të drejtë pohon se, edhe në rast të supozimit të agresionit të kundërligjshëm, nuk do të justifikohet gjuajtja e **Hajriz Gashit**. Nuk ka qenë e **domosdoshme** në kuptimin e Nenit 8, par. 2 të KPK-së, sepse kushtet e përcaktuara janë këto:

a) sulm i kundërligjshëm, **real dhe i menjëhershëm**; b) qëllimi i të sulmuarit për ta **mbrojtur** veten apo personin tjetër; c) masat e mbrojtjes të zbatohen **ndaj agresorit**; d) situata **objektive**, jo vetëm e supozuar nga i pandehuri, **duhet patjetër të kërkojë** masat e mbrojtjes, dhe e) mbrojtja duhet t’i përshtatet **llojit dhe shkallës së rrezikut** të agresionit (**parimi i proporcionalitetit**).

Siç është diskutuar është për t’u dyshuar se agresioni i Abedin Gashit të justifikojë masën e mbrojtjes. Sulmi i mundshëm kishte marrë fund kur i pandehuri përdori armën e vet. Po ashtu, mjetet e përdorura ishin **jo-proporcionale** kundrejt sulmit. I pandehuri kishte një strehim relativisht të sigurt dhe ishte i ekspozuar vetëm në mënyrë indirekte ndaj të shtënave që vinin nga jashtë. Duke marrë armën automatike (e cila ishte tashmë e mbushur me plumba) dhe duke kërcyer në ballkonin e shtëpisë, ai ishte qartë në pozitë superiore. Vëllezërit Abedin dhe **Kasum Gashi** ishin vënë në mëshirën e tij. I pandehuri ishte i vetëdijshëm për situatën në fjalë dhe ishte i vetëdijshëm për rrezikun e gjuajtjes nga një distancë aq e afërt (5-7 metra) nga pushka automatike e drejtuar kah personat të cilët ishin poshtë. Siç dëshmohet edhe nga raporti mjekësor dhe autopsia, Abedin Gashi ishte vrarë nga një plumb i cili i kishte hyrë nga pjesa e sipërme e krahut dhe ia kishte shpuar gjoksin dhe mushkëritë. **Kasum Gashi** ishte qëlluar nga një plumb tjetër i cili i kishte hyrë në trup për fundi bërrylit të djathtë duke depërtuar në stomak. Numri i kufizuar i të shtënave dhe efekti i shkaktuar tregojnë se të shtënat ishin të drejtuara kundër të dy vëllezërve, dhe nuk ishin shkrepur vetëm sa për t’i “frikësuar”.

I tërë veprimi duket sikur një ekzekutim i qëllimshëm i kundërshtarëve dhe jo vetëm si mënyrë për t’i frikësuar dhe për t’i përzënë. Përdorimi i armës automatike kundër agresorëve të cilët qartë nuk ishin të armatosur njësoj në rastin më të mirë **në mënyrë të jashtëzakonshme** do të mund të justifikohet si masë e mbrojtjes së **nevojshme** kur

⁸ Dëshmia e Hajriz Gashit e dhënë në Prokurori, më 10 janar 2008, faqe 235



rrethanat e tjera do të mund të shkaktonin një situatë të rrezikshme për jetën për personin e sulmuar. Madje edhe në këso rastesh, i pandehuri do të duhej t'i **paralajmëronte** agresorin para se të hapte zjarr. Duke pasur parasysh tërë këtë që u tha, plumbat e shkrepur nga **Hajriz Gashi** nuk kanë qenë mjet për mbrojtjen e nevojshme.

Gjykata Supreme konstaton se i pandehuri Hajriz Gashi ka **kryer** veprën penale të **Vrasjes** në kundërshtim me Nenin 146 të KPK-së duke privuar nga jeta Abedin Gashin. Kjo vrasje ka qenë e kundërligjshme dhe nuk justifikohet me mbrojtjen e nevojshme, siç u tha edhe më lart. Nuk ka dyshim se e shtëna në fjalë ka **shkaktuar** vdekjen e Abedin Gashit. Lidhja në mes të veprimeve të të pandehurit dhe epilogut fatkeq nga kjo gjuajtje dëshmohet përmes raporteve mjekësore. Këto të shtëna në përgjithësi kanë për qëllim vrasjen e njeriut dhe nga përvoja mësojmë se një gjë të tillë e din secili përdorues i armës automatike, prandaj rrjedha e ngjarjeve nuk ka qenë e papritur.

I pandehuri **Hajriz Gashi** po ashtu ka vepruar me **dashje**: Ai ka drejtuar armën kundër të pambrojturit Abedin Gashit i cili po qëndronte para shtëpisë. Raporti mjekësor kundërshton deklaratën e të pandehurit se kishte shtënë ashtu pa marrë mirë në shenjë. Synimi i tij ishte ta qëllonte. Gjykata Supreme është e mendimit se më së paku i pandehuri kishte vepruar me **dashje eventuale**. Ai ishte në dijeni për rrezikun nga përdorimi i armës dhe për mundësinë që plumbi i shkrepur nga një distancë aq e afërt në drejtim të Abedin Gashit do të mund ta rrokte duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse. Skena e përshkruar në mënyrë të qartë tregon se i pandehuri ka qenë në dijeni për të gjitha rrethanat dhe rreziqet dhe përkundër kësaj, prapë ka shtënë.

Përgjegjësia penale e **Hajriz Gashit** nuk përjashtohet në bazë të Nenit 8 të KPK-së, sepse i pandehuri ka mundur gabimisht të supozojë se ka qenë në situatë e cila ia kërcënonte jetën dhe se mbrojtja e zgjedhur ka qenë e nevojshme. Siç është diskutuar, ai ka qenë në dijeni se nuk kishte ndonjë kërcënim të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm dhe se mënyra e tij e mbrojtjes ishte jo-proporcionale me shkallën e agresionit.

I pandehuri **Hajriz Gashi** po ashtu ka kryer **një Vrasje në tentativë** në kundërshtim me Nenin 146, lidhur me Nenin 20 të KPK-së kur ka shtënë duke plagosur **Kasum Gashin**. Veprimi i tij i plotëson kushtet e veprës penale të Vrasjes sipas Nenit 146 të KPK-së. Ai ka qëlluar në drejtim të viktimës dhe ka qenë në dijen mbi pasojat e veprimit të tij. Megjithatë, ai nuk ka privuar nga jeta **Kasum Gashin**, prandaj vepra ka qenë tentativë. Hajriz Gashi ka vepruar qëllimisht duke marrë parasysh edhe vdekjen e mundshme të personit të qëlluar, por përkundër kësaj të njëjtin e kishte marrë në shenjë.

Neni 146 i KPK-së përcakton që “Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me së paku pesë vjet burgim.” Neni 20, par. 3 parasheh që personi që tenton të kryejë veprë penale dënohet më butë sesa kryerësi; dënimi mbetet më i ulët sesa dënimi i përcaktuar për atë veprë penale. Sipas Nenit 147, par. 11 të KPK-së, dënimi me burgim prej së paku dhjetë vjetësh ose me burgim afatgjatë shqiptohet kundër personit i cili me dashje kryen dy apo më shumë vrasje [...].




Për shkak të faktit se vrasja dhe vrasja në tentativë janë kryer gjatë të njëjtit rast, nën kushtet e njëjta, me dashjen e njëjtë të kryerësit, na duket e udhës që dënimi të matet në bazë të Nenit 147, pikës 11 të KPK-së, ndërsa të shqiptohet një dënim për të dy veprat penale. Gjykata e shkallës së dytë në këtë mënyrë shqipton një dënim prej pesëmbëdhjetë (15) vjetësh **burgim**. Kjo e reflekton qëllimin e dënimit sipas nenit 34 të KPK-së, sa i përket përsëritjes së veprave penale dhe parandalimit të personave të tjerë që të kryejnë krime të ngjashme. Dënimi i shqiptuar gjithashtu do të kënaq palën e dëmtuar dhe paraqet një mjet për pajtimin e familjeve të përfshira.

Gjykata Supreme merr parasysht përgjegjësinë individuale të kryerësit dhe rrethanat e posaçme gjatë të cilave ka ndodhur krimi. Faktet se viktima ka dhënë kontribut në konflikt dhe në zgjidhjen e tij të papërshtatshme, dhe se **Hajriz Gashi**, si djali më i madh është ndjerë i obliguar që ta mbrojë shtëpinë e familjes janë faktorë lehtësues. Siç është sqaruar më lart, i pandehuri nuk mund të përfitojë nga neni 8 paragrafi 4 i KPK-së i cili lejon zvogëlimin e dënimit në rast të tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme.

Gjykata Supreme pjesërisht pranon ankesën e paraqitur në emër të **Hajriz Gashit** lidhur me dënimin e shqiptuar për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafi 2 të KPK-së. Ankesa është **pjesërisht e arsyetuar** sepse dënimi prej katër (4) viteve burgim është shumë i ashpër. Me siguri është shqiptuar për shkak të lirimit të supozuar të pandehurit nga akuzat për Vrasje dhe Vrasje në tentativë. Këto janë veprat penale relevante të cilat kërkojnë një dënim të rëndë i cili tani është shqiptuar nga gjykata e shkallës së dytë. Zvogëlimi i dënimit për kryerjen e veprës penale nën nenin 328 paragrafin 2 të KPK-së në një vit e gjysmë (1 ½) është vetëm se i pandehuri nuk ka qenë i pari që ka shtënë, dhe përdorimi i armës gjithashtu është provokuar nga të tjerët. Përdorimi i armës nuk është arsyetuar me mbrojtjen e nevojshme. Përfundimisht, Gjykata Supreme merr parasysht rrezikun e shkaktuar nga posedimi dhe përdorimi i armëve. Duke e pasur parasysht nenin 71 paragrafin 2 të KPK-së, e shoh si të duhur që të shqiptoj një dënim unik prej **gjashtëmbëdhjetë (16) viteve**. Sipas nenit 73 paragrafi 1 të KPK-së, koha të cilën **Hajriz Gashi** e ka kaluar në paraburgim është dashur të llogaritet.

Lidhur me të pandehurin Kasum Gashi

Gjykata Supreme gjen se ankesa e paraqitur në emër të pandehurit **Kasum Gashi** është pjesërisht e bazuar. Dënimi është dashur të zvogëlohet duke i pasur parasysht rrethanat e veçanta të rastit, në veçanti lëndimit serioz trupor të tij të shkaktuar nga Hajriz Gashi si dhe pranimin e hershëm të fajësisë të **Kasum Gashi**. Zvogëlimi i dënimit në një vit e gjysmë (1.5) në vend të tri (3) viteve të shqiptuara konsiderohet si i duhur, duke e pasur parasysht dënimin e paraparë me nenin 34 të KPK-së. Përkundër mendimit juridik të avokatit mbrojtës, reagimi i shtetit ndaj kësaj shkelje të nenit 328 paragrafi 2 duhet patjetër të jetë i perceptueshëm. Ekziston nevoja për një mesazh të fuqishëm ndaj të pandehurit dhe publikut se posedimi i armëve dhe përdorimi i pamenduar nuk mund të konsiderohet më tepër si vepër e parëndësishme. Shoqëria moderne nuk mund të pranojë që secili qytetar të merr të drejtën e pretenduar në duart e veta siç është vënë në praktikë në strukturat arkaike. Të gjithë duhet të mësojnë se ekzistojnë mjete të tjera për zgjidhjen



e konflikteve dhe se përdorimi i forcës duhet t'i rezervohen organeve të shtetit të kualifikuara për mbrojtjen e qytetarëve dhe kujdesin për të drejtat e tyre. Në rastin konkret, është e dënueshme që i pandehuri i është afruar shtëpisë së **Shaqir Gashit** me revolen e tij, dhe se ai ka qenë i pari i cili ka shtënë në të dhe në banorët e mundshëm brenda saj.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës ankimore është bazuar në nenet 99, 100, 103 të KPK-së.

Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv.

Kryetar i kolegjit:

Gjyqtar i EULEX-it Horst Proetel

Anëtare e kolegjit:

Gjyqtare e Gjykatës Supreme Marije Ademi

Anëtare e kolegjit:

Gjyqtare e Gjykatës Supreme Nesrin Lushta

Anëtar i kolegjit:


Gjyqtar i EULEX-it Francesco Florit

Anëtar i kolegjit:

Gjyqtar i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger

Procesmbajtëse:

Chiara Rojek



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

7 shkurt 2012

Ap – Kz 373/10

Prishtinë

KËSHILLË JURIDIKE: Në bazë të nenit 430 dhe nenit 398 të KPPK-së, palët mund të paraqesin ankesë kundër këtij aktgjykimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit.